

VENDIM
Nr. 219, datë 17.4.2025

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR QËLLIME TË SIGURISË,
QËNDRUESHMËRISË DHE SAKTËSISË NË REGJISTRIMIN E TË DHËNAVE PËR
DOMAIN-NAME-T “AL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 133, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për qëllime të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për *domain-name-t* “.al”, sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS

RREGULLA
**PËR QËLLIME TË SIGURISË, QËNDRUESHMËRISË DHE SAKTËSISË NË REGJISTRIMIN
E TË DHËNAVE PËR DOMAIN-NAME-T “AL”**

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) krijon dhe mban regjistrin e emrave të *domain-eve* me nivel të lartë “.al” ose “regjistrin e emrave të *domain-eve* TLD.al”, si dhe të subjekteve që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të *domain-it*, bazuar në shkronjën “dh”, të nenit 12, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në pikën 34, të nenit 5, të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”.
2. Me qëllim garantimin e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe saktësisë në regjistrimin e të dhënave për *domain-name-t* “.al”, regjistri i AKEP-it, sipas pikës 1 të këtyre rregullave, përmban emrat e *domain-eve* (dhe nën-*domain-eve*) ccTLD.al, emrat e *domain-eve* të internetit të regjistruar në Republikën e Shqipërisë me prapashtesën “.al”, të dhënat e poseduesve të tyre, historikun e veprimeve me *domain-et* me “.al” dhe sistemin ccTLD.al.
3. Kostot për krijimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e regjistrit të emrave të *domain-eve* “.al”, përballohen nga pagesat që kryhen në AKEP për regjistrimin e emrave të *domain-eve*, pagesat e subjekteve të autorizuar për regjistrim *domain-esh* me “.al” dhe burime të tjera të ligjshme.
4. AKEP-i mbledh dhe mban të dhëna të sakta, të plota, të regjistrimit të emrit të *domain-it* në një regjister të dedikuar, duke respektuar ligjin e mbrojtjes së të dhënave lidhur me të dhënat personale.
5. Regjistri me të dhënat e regjistrimit të emrave të *domain-it* do të përmbajë informacionin e nevojshëm për të identifikuar e kontaktuar mbajtësit e emrave të *domain-it* “.al”, si dhe pikat e kontaktit që administrojnë emrat e *domain-eve* “cc.TLD.al”. Informacioni i kërkuar sipas kësaj pike përfshin:
 - a) emrin e *domain-it* nën “.al”;
 - b) datën e regjistrimit;
 - c) datën e përfundimit të vlefshmërisë;

ç) për subjektet tregtare, institucionet, organizatat: emrin e subjektit, numrin NUIS/NIPT, adresën postare, adresën e *email*-it dhe numër telefoni të pikës së kontaktit;

d) për individët: emrin dhe mbiemrin e të regjistruarit, numrin personal sipas dokumentit ID, adresën postare, adresën e *email*-it dhe numrin e telefonit, adresën e *email*-it të kontaktit dhe numrin e telefonit të pikës së kontaktit, që administrojnë emrin e *domain*-it, në rast se ato janë të ndryshme nga ato të mbajtësit të *domain*-it.

6. Mbajtësit e emrave të *domain*-it “.al” dhe pikat e kontaktit, që administrojnë emrat e *domain*-eve “cc.TLD.al” janë të detyruar të informojnë pa vonesë AKEP-in për çdo ndryshim në të dhënat e kërkuara, sipas pikës 5 të këtyre rregullave, por, në çdo rast, jo më vonë se tre muaj nga data e ndryshimit.

7. AKEP-i dhe subjektet e autorizuar prej tij, për ofrimin e shërbimeve të regjistrimit të emrit të *domain*-it “.al”, miratojnë politika të sigurisë dhe procedurat, përfshirë procedurat e verifikimit për të siguruar që regjistri i përmendur në pikën 1 të këtyre rregullave përfshin informacion të saktë e të plotë.

8. Politikat e sigurisë dhe procedurat e miratuara sipas pikës 7 të këtyre rregullave publikohen në faqen zyrtare të internetit të AKEP-it.

9. Subjektet, që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrit të *domain*-it “.al”, janë të detyruara të zbatojnë dhe të përshtatën masat e sigurisë së sistemit teknik të administrimit të *domain*-it “.al”, me shpenzimet e tyre dhe brenda afateve të përcaktuara nga AKEP-i.

10. AKEP-i bashkëpunon me autoritetin përgjegjës për sigurinë kibernetike në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi për sigurinë kibernetike, në lidhje me infrastrukturën e informacionit të lidhura me *domain-name*-t.

11. AKEP-i dhe subjektet, që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të *domain*-it, pas regjistrimit të një emri *domain*-i, bëjnë të disponueshme për publikun të dhënat e regjistrimit të emrit të *domain*-it, që nuk janë të dhëna personale.

12. Regjistri me emrat ccTLD.al dhe subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të *domain*-it, me marrjen e një kërkesë të ligjshme dhe të vërtetuar siç duhet nga kërkuesit legjitimë, vënë në dispozicion të dhënat specifike të regjistrimit të *domain*-it, duke respektuar ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

13. Regjistri me emrat ccTLD.al dhe subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të *domain*-it përgjigjen brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga marrja e kërkesës, sipas pikës 12 të këtyre rregullave. Procedurat dhe politikat që ndiqen në lidhje me ofrimin e të dhënave specifike të kërkuara sipas pikës 11 të këtyre rregullave publikohen.

14. AKEP-i dhe subjektet që ofrojnë shërbime të regjistrimit të emrave të *domain*-it bashkëpunojnë me qëllim shmangien e dublikimit të mbledhjes së të dhënave me regjistrin/at e emrave të *domain*-eve.